REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

P R O J E K T L I GJ

Nr._____/2026

PËR

DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.61/2012, "PËR AKCIZAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR[1]

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Në ligjin nr.61/2012, "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Pika 1, e nenit 18 "Mënyra e llogaritjes", ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Akciza është një taksë specifike, me përjashtim të akcizës së cigareve, e cila përcaktohet sipas nenit 79, të këtij ligji.".

Neni 2

Pas pikës 7, të nenit 78 "Përkufizime", shtohet pika 8, me këtë përmbajtje:

"8. "Prodhues i produkteve të duhanit" është një person fizik ose juridik që prodhon produkte duhani dhe përcakton çmimin maksimal të shitjes me pakicë.".

[1] *Ky ligj është përafruar pjesërisht me Direktivën e Këshillit 2011/64/BE, datë 21 qershor 2011, "Mbi strukturën dhe normat e akcizës që zbatohen për duhanin e përpunuar (kodifikim)"*

Neni 3

Në nenin 79 “Detyrimet”, bëhen ndryshimi dhe shtesat e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Baza për llogaritjen e akcizës për cigaret është 1 000 copë/fije dhe çmimi maksimal i shitjes me pakicë, ndërsa për purot dhe cigarillot është kg.”.

2. Pas pikës 2 shtohen pikat 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8, me këtë përmbajtje:

“3. Akciza për cigaret përbëhet nga një komponent specifik, i përcaktuar në një shumë të caktuar për një sasi prej 1 000 copë/fije dhe nga data 1 janar 2030 edhe nga një komponent proporcional (*ad valorem*), i llogaritur si përqindje e çmimit maksimal të shitjes me pakicë të cigareve.

4. Çmimi maksimal i shitjes me pakicë i cigareve të hedhura për konsum në territorin e Republikës së Shqipërisë është çmimi i vendosur për çdo markë të cigareve nga prodhuesit dhe importuesit, i cili përfshin akcizën, taksën doganore dhe tatimin mbi vlerën e shtuar.

5. Prodhuesit dhe importuesit duhet të deklarojnë çmimin maksimal të shitjes me pakicë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, jo më vonë se 10 ditë përpara hedhjes për konsum të cigareve. Cigaret nuk mund të shiten me çmim të shitjes me pakicë më të lartë se çmimi maksimal i deklaruar.

6. Nga data 1 janar 2030, akciza totale (akciza specifike dhe proporcionale (*ad valorem*) duke përjashtuar tatimin mbi vlerën e shtuar) për cigaret nuk do të jetë më e ulët se vlera ekuivalente në lekë e shumës 90 euro për 1 000 copë/fije. Nga data 1 janar 2033, totali i akcizës (akciza specifike dhe proporcionale (*ad valorem*), duke përjashtuar tatimin mbi vlerën e shtuar) për cigaret duhet të jetë të paktën 60% e çmimit mesatar të ponderuar të shitjes me pakicë të cigareve të hedhura për konsum dhe në çdo rast, jo më pak se vlera ekuivalente në lekë e shumës 90 euro për 1 000 copë/fije, pavarësisht nga çmimi mesatar i ponderuar i shitjes me pakicë të cigareve të hedhura për konsum.

7. Çmimi mesatar i ponderuar i shitjes me pakicë përcaktohet jo më vonë se data 1 mars e çdo viti dhe llogaritet duke marrë në konsideratë vlerën totale të të gjitha cigareve të hedhura për konsum gjatë vitit kalendarik të mëparshëm, bazuar në çmimin e shitjes me pakicë që përfshin të gjitha

taksat, pjesëtuar me sasinë totale të cigareve të hedhura për konsum gjatë asaj periudhe.

8. Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen procedurat për zbatimin e këtij neni.”.

Neni 4

Shtojca nr.1, “Mallrat e tatueshme me akcizë në Republikën e Shqipërisë”, bashkëlidhur ligjit, zëvendësohet me shtojcën nr.1 “Mallrat e tatueshme me akcizë në Republikën e Shqipërisë”, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare” dhe i fillon efektet nga data 1 janar 2027, përjashtimisht nenit 3, që i fillon efektet nga data 1 janar 2030, ndërsa fjalia e dytë e pikës 6, të këtij neni, i fillon efektet nga data 1 janar 2033.

K R Y E T A R I

NIKO PELESHI

SHTOJCA NR.1
MALLRAT E TATUESHME ME AKCIZË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Kategoria	Kodi NK	Përshkrimi	Shkalla e taksimit
I. KAFE			
C100 Kafe e papjekur	09 01 11 00 09 01 12 00	Kafe jo e pjekur e dekafeinizuar ose jo	0
C200 Kafe e pjekur	09 01 21 00 09 01 22 00	Kafe e pjekur e dekafeinizuar ose jo	63.85335 lekë/kg
C300 Lëkura, lëvoret zëvendësuesit e kafesë	09 01 90	Lëkura dhe lëvoret e kafesë. Zëvendësuesit e kafesë që përmbajnë kafe	53.21112 lekë/kg
C900 Ekstrakte, esenca, koncentrate kafeje dhe përgatitje prej tyre	21 01 11 00 21 01 12 92 21 01 12 98	Ekstrakte, esenca, koncentrate kafeje dhe përgatitje prej tyre (neskafe etj.)	266.05561 lekë/kg kafe
II. BIRRË, VERË, ALKOOL DHE PIJE ALKOOLIKE			
B000 Birra	22 03	Birra nga malto me shkallë alkoolometrike ndaj volumit më të madh se 0.5%	755.59792 lekë/HL/shkallë alkoolometrike
W200 Vera e qetë dhe pijet e qeta të fermentuara	22 04 21 22 04 29 22 04 30 22 04 30 10 22 04 30 96 22 04 30 98 22 05 10 10 22 05 90 10 22 06 00 10 22 06 00 59 22 06 00 89	Verë e qetë dhe musht rrushi; Vermuth e verëra të tjera të përgatitura nga bimë ose substanca aromatizuese; Pije të tjera të fermentuara (p.sh. musht molle, musht dardhe, hydromel); përzierje të pijeve të fermentuara dhe përzierje të pijeve të fermentuara dhe pijeve joalkoolike të pagazuara. - nga prodhues vendas e të huaj me sasi < = 10 000 hektolitër/vit - nga prodhues vendas e të huaj me sasi > 10 000 hektolitër/vit	- 3192.667 lekë/HL për verërat me forcë alkoolike deri në 12,5 gradë; dhe - 4256.89 lekë/HL për verërat me forcë alkoolike mbi 12,5 gradë - 10642.224 lekë/HL për verërat me forcë alkoolike deri në 12,5 gradë; dhe - 12770.669 lekë/HL për verërat me forcë alkoolike mbi 12,5 gradë
W300 Vera spumante, shampanja dhe pije të fermentuara dhe të gazuara	22 04 10 22 04 21 06 22 04 21 07 22 04 21 08 22 04 21 09 22 05 10 10 22 05 90 10 22 06 00 39 22 06 00 31 22 06 00 51 22 06 00 81	Verërat spumante, shampanja; verë ndryshe nga ato të nënkreut 220410, në shishe me tapa "kërpudhë" që lidhet me mbërthyes apo tela; verë e ndërtuar ndryshe me një presion të pranueshëm në sajë të dyoksidit të karbonit. Vermuth e verëra të tjera të përgatitura nga bimë ose substanca aromatizuese të një force alkoolike ndaj volumit prej 18% apo më pak.	5533.957 lekë/HL
		Pije të tjera të fermentuara (p.sh. musht molle, musht dardhe, hydromel); përzierje të pijeve të fermentuara dhe përzierjet e pijeve të fermentuara dhe pijeve	3320.374 lekë/HL

		joalkoolike të gazuara. Cider dhe cider dardhe me përmbajtje alkooli 8,5%	
I000 Pijet alkoolike të ndërmjetme	22 04 21 85 22 04 21 86 22 04 21 87 22 04 21 88 22 04 21 89 22 04 21 90 22 04 21 91 22 04 21 93 22 04 21 94 22 04 21 95 22 04 21 96 22 04 21 97 22 04 21 98 22 04 29 85 22 04 29 86 22 04 29 87 22 04 29 88 22 04 29 89 22 04 29 90 22 04 29 91 22 04 29 93 22 04 29 94 22 04 29 95 22 04 29 96 22 04 29 97 22 04 29 98 22 05 10 10 22 05 10 90 22 05 90 10 22 05 90 90 22 06 00 10 22 06 00 39 22 06 00 59 22 06 00 89	Pijet alkoolike të ndërmjetme me një forcë alkooli mbi 15% volum, por që nuk e kalon 22% volum; Sipas përcaktimeve të nenit 74 të ligjit.	5533.957 lekë/HL
S200 Pije alkoolike (*Spirituous Beverages*)	22042192 22042193 22042194 22042195 22042196 22042197 22042198 22042992 22042993 22042994 22042995 22042996 22042997 22042998 22051090 22059090 22060010 22060039 22060059 22060089 22082012 22082014 22082026	Pije alkoolike; të përfituara nga distilimi i verës së rrushit apo të bërsive të rrushit, *Whisky*, Rum dhe pije të tjera të përfituara nga distilimi i produkteve të fermentuara nga kallami i sheqerit, Gin dhe Geneva, Vodka, likere dhe tonikë, uzo.	89926.795 lekë për HL alkool anhidër

	22082027 22082029 22082040 22082062 22082064 22082086 22082087 22082089 22082088 22083011 22083019 22083030 22083041 22083049		
	22083061 22083069 22083071 22083079 22083082 22083088 22084011 22084031 22084039 22084051 22084091 22084099 22085011 22085019 22085091 22085099 22086011 22086019 22086091 22086099 22087010 22087090 22089011 22089019 22089033		
S300 Alkooli etilik jo i denatyruar	22071000 22089091 22089099	Alkool etilik jo i denatyruar i një force alkoolike ndaj volumit prej 80% volum apo më shumë	47890.009 lekë për HL alkool anhidër
S400 Alkool etilik i denatyruar	22072000	Alkool etilik i denatyruar	0 (zero)
S400 Rakia, sipas përcaktimeve të nenit 66 të ligjit	22082028	Raki	21284.449 lekë për HL alkool anhidër
S500 Produkte të tjera që përmbajnë alkool etilik	Kapitujt 17 deri 22 të NK	Të gjitha produktet që kanë një shkallë alkoolometrike efektive mbi 1,2% ndaj volumit dhe pavarësisht klasifikimit në sistemin NK, sipas nenit 64 të ligjit	47890.0091 lekë për HL alkool anhidër
III.	**DUHAN DHE NËNPRODUKTET E TIJ**		
T300 Puro dhe cigarillos	24 02 10 00	Puro dhe cigarillos që përmbajnë duhan (lekë/kg)	8,100 lekë/kg më 1 Janar, 2027 8,450 lekë/kg më 1 Janar, 2028 8,800 lekë/kg më 1 Janar, 2029 9,150 lekë/kg më 1 Janar, 2030 9,500 lekë/kg më 1 Janar, 2031

			9,850 lekë/kg më 1 Janar, 2032 10,200 lekë/kg më 1 Janar, 2033
T200 Cigare që përmbajnë duhan	24 02 20	Cigare që përmbajnë duhan (lekë/fije cigare)	8,100 lekë/1000 fije më 1 Janar, 2027 8,450 lekë/1000 fije më 1 Janar, 2028 8,800 lekë/1000 fije më 1 Janar, 2029 2% të çmimit të shitjes me pakicë + 9,150 lekë/1000 fije më 1 Janar, 2030 3% të çmimit të shitjes me pakicë + 9,150 lekë/1000 fije më 1 Janar, 2031 4% të çmimit të shitjes me pakicë + 9,150 lekë/1000 fije më 1 Janar, 2032 5% të çmimit të shitjes me pakicë + 9,150 lekë/1000 fije më 1 Janar, 2033
T500 Puro, cigarillos dhe cigare me zëvendësues duhani	24 02 90	Puro, cigarillos dhe cigare me zëvendësues duhani (lekë/kg)	8,100 lekë/kg më 1 Janar, 2027 8,450 lekë/kg më 1 Janar, 2028 8,800 lekë/kg më 1 Janar, 2029 9,150 lekë/kg më 1 Janar, 2030 9,500 lekë/kg më 1 Janar, 2031 9,850 lekë/kg më 1 Janar, 2032 10,200 lekë/kg më 1 Janar, 2033
T400 Duhan tjetër i përpunuar dhe zëvendësuesit e duhanit	24 03	Duhan tjetër i përpunuar dhe zëvendësuesit, duhan me dredhje (lekë/kg)	8,100 lekë/kg më 1 Janar, 2027 8,450 lekë/kg më 1 Janar, 2028 8,800 lekë/kg më 1 Janar, 2029 9,150 lekë/kg më 1 Janar, 2030 9,500 lekë/kg më 1 Janar, 2031 9,850 lekë/kg më 1 Janar, 2032 10,200 lekë/kg më 1 Janar, 2033
		Duhan i përpunuar me gjethe duhani të kultivuara në Shqipëri (lekë/kg)	4,100 lekë/kg më 1 Janar, 2027 5,783 lekë/kg më 1 Janar, 2028 7,467 lekë/kg më 1 Janar, 2029 9,150 lekë/kg më 1 Janar, 2030 9,500 lekë/kg më 1 Janar, 2031 9,850 lekë/kg më 1 Janar, 2032 10,200 lekë/kg më 1 Janar, 2033
T401 Produkte të destinuara për thithje pa djegie	2404 12	Produktet që përmbajnë nikotinë lëng (lekë/ml)	24 lekë/ml më 1 Janar, 2027 28 lekë/ml më 1 Janar, 2028 32 lekë/ml më 1 Janar, 2029 36 lekë/ml më 1 Janar, 2030 40 lekë/ml më 1 Janar, 2031 44 lekë/ml më 1 Janar, 2032 48 lekë/ml më 1 Janar, 2033
		Produkte të destinuara për thithje pa djegie me nikotinë që nuk përmbajnë duhan ose duhan të rindërtuar (lekë/kg)	9,450 lekë/kg më 1 Janar, 2027 10,150 lekë/kg më 1 Janar, 2028 10,850 lekë/kg më 1 Janar, 2029 11,550 lekë/kg më 1 Janar, 2030 12,250 lekë/kg më 1 Janar, 2031 12,950 lekë/kg më 1 Janar, 2032 13,650 lekë/kg më 1 Janar, 2033
		Produkte duhani për përdorim oral (lekë/kg)	8,850 lekë/kg më 1 Janar, 2027 8,950 lekë/kg më 1 Janar, 2028 9,050 lekë/kg më 1 Janar, 2029 9,150 lekë/kg më 1 Janar, 2030 9,250 lekë/kg më 1 Janar, 2031 9,350 lekë/kg më 1 Janar, 2032 9,450 lekë/kg më 1 Janar, 2033

	24 04 91	Qeset me nikotinë (lekë/kg)	3,500 lekë/kg më 1 Janar, 2027 4,200 lekë/kg më 1 Janar, 2028 5,040 lekë/kg më 1 Janar, 2029 6,048 lekë/kg më 1 Janar, 2030 7,258 lekë/kg më 1 Janar, 2031 8,710 lekë/kg më 1 Janar, 2032 10,450 lekë/kg më 1 Janar, 2033
	240419	Produkte të destinuara për thithje pa djegie, që nuk përmbajnë duhan ose duhan të rindërtuar, që nuk përmbajnë nikotinë (lekë/ml)	11 lekë/ml më 1 Janar, 2027 13 lekë/ml më 1 Janar, 2028 15 lekë/ml më 1 Janar, 2029 16 lekë/ml më 1 Janar, 2030 18 lekë/ml më 1 Janar, 2031 20 lekë/ml më 1 Janar, 2032 22 lekë/ml më 1 Janar, 2033
T402 Duhan me ngrohje	24 04 11	Duhan me ngrohje, pa djegie (lekë/kg)	9,450 lekë/kg më 1 Janar, 2027 10,150 lekë/kg më 1 Janar, 2028 10,850 lekë/kg më 1 Janar, 2029 11,550 lekë/kg më 1 Janar, 2030 12,250 lekë/kg më 1 Janar, 2031 12,950 lekë/kg më 1 Janar, 2032 13,650 lekë/kg më 1 Janar, 2033
T403 Shisha, nargjile	24 03 11	Shisha, nargjile (përzierje për tymosje me duhan) (lekë/kg)	2,213 lekë/kg 1 Janar, 2027 2,238 lekë /kg 1 Janar, 2028 2,263 lekë/kg 1 Janar, 2029 2,288 lekë/kg 1 Janar, 2030 2,313 lekë/kg 1 Janar, 2031 2,338 lekë/kg 1 Janar, 2032 2,363 lekë/kg 1 Janar, 2033
		Shisha, nargjile (përzierje për tymosje) përpunuar me gjethe duhani të kultivuara në Shqipëri (lekë/kg)	1,438 lekë/kg 1 Janar, 2027 1,938 lekë/kg 1 Janar, 2028 2,263 lekë/kg 1 Janar, 2029 2,288 lekë/kg 1 Janar, 2030 2,313 lekë/kg 1 Janar, 2031 2,338 lekë/kg 1 Janar, 2032 2,363 lekë/kg 1 Janar, 2033
	2403 99 90	Shisha, nargjile (përzierje për tymosje pa duhan) (lekë/kg)	2,213 lekë/kg 1 Janar, 2027 2,238 lekë/kg 1 Janar, 2028 2,263 lekë/kg 1 Janar, 2029 2,288 lekë/kg 1 Janar, 2030 2,313 lekë/kg 1 Janar, 2031 2,338 lekë/kg 1 Janar, 2032 2,363 lekë/kg 1 Janar, 2033
IV. PRODUKTET ENERGJETIKE			
E200 Vajrat vegjetale dhe shtazore të klasifikuara në krerët 1507 deri 1518 të NK nëse përdoren për ngrohje apo motorë	1507 deri 1518	Vajrat dhe dhjamërat prej kafshëve apo vegjetale dhe produktet prej tyre	Sipas përcaktimeve të neneve 50 e 51 të ligjit
E201 Qymyri	2701	Qymyr; briketa, forma vezake dhe lëndë djegëse të ngjashme të forta të prodhuar prej qymyrit	0 lekë/kg
E202 Linjiti	2702	Linjit, nëse është apo jo i aglomeruar, duke përjashtuar qelibarin e zi	0 lekë/kg

E203 Koks dhe gjysmë koks	2704	Koks dhe gjysmë koks prej qymyrit, linjitit apo prej torfe, nëse është apo jo i aglomeruar; karbon i konvertuar	0 lekë/kg
E204 Gaz qymyri, gaz uji, gaz prodhimi	2705	Gaz qymyri, gaz uji, gaz prodhimi dhe gazra të tjera të ngjashme, përveç gazrave të naftës dhe hidrokarbureve të tjera gazoike	0 lekë/kg
E205 Katran i distiluar nga qymyri	2706	Katran i distiluar nga qymyri, nga linjiti apo nga torfa, dhe katrane të tjera minerale, nëse janë apo jo të dehidratuara apo pjesërisht të distiluara, përfshirë katranet e rindërtuara	0 lekë/kg
E300 Vajra minerale	27071010 27071090 27072010 27072090 27073010 27073090 27075010 27075090	Produktet e vajrave minerale që u përkasin kodeve NK të kreut 2707	53.21112 lekë/litri
E400	27 10 12 11	Naftë që kërkon një proces specifik përpunimi	53.21112 lekë/litri
E410	27 10 12 41 27 19 12 45 27 10 12 49	Vajra të lehta (benzinë dhe benzol) Benzinë dhe benzol pa plumb, me përmbajtje plumbi jo më tepër se 0,013 gr/litër Me më pak se 95 oktan Me 95-98 oktan Me 98 e më shumë oktan	39.37623 lekë/litri
E420	27 10 12 51 27 10 12 59	Benzinë me plumb, me përmbajtje plumbi më tepër se 0,013 gr/litër Me më pak se 98 oktan Me 98 e më shumë oktan	53.21112 lekë/litri
E430	27 10 19 11 deri 27 10 19 29 27 10 19 21 deri 27 10 19 25	Vajguret Karburantet, tip vajguri	21.28445 lekë/litri 21.28445 lekë/litri
E440	27 10 19 31 deri 27 10 19 48	Vajra të rënda (gazoil)	39.37623 lekë/litri
E450	27 10 19 51 deri 27 10 19 69	Vajra të rënda si lëndë djegëse (lëndë djegëse, solar, mazut)	39.37623 lekë/kg
E460	27 10 20	Biodiesel me vajra nafte	39.37623 lekë/litri
E470	27 10 19 71 deri 27 10 19 99	Vajra lubrifikante dhe vajra të tjera	42.5689 lekë/kg
E471	27 109 100 deri 27109900	Mbetje vajrash	5.32111 lekë/kg
E472	27 12 10 90	Graso	42.5689 lekë/kg

E480	27 13 11 00 27 13 12 00	Koks nafte	2.12844 lekë/kg
E490	27 13 20 00	Bitum nafte	5.32111 lekë/kg
E490	27 13 90	Mbetje të vajrave të naftës dhe të mineraleve bituminoze (bitumen)	5.32111 lekë/kg
E491	27 15	Përzierje bituminoze të bazuara në asfaltin natyror, në bitumin e naftës, në katranin mineral ose në terpentinën e katranit mineral (masticet bituminoze) Vernik Bituminoz (p.sh. asfalto-beton)	5.32111 lekë/kg bitum
E492	27 14 90 00	Zhavorr bituminoz	0.319267 lekë/kg
E500 Gazet e naftës dhe hidrokarbure të tjera gazoike	27111211 27111219 27111291 27111293 27111294 27111297 27111310 27111330 27111391 27111397 27111400	Gazet e naftës dhe hidrokarbure të tjera gazoike për përdorim si lëndë djegëse për motor automjetesh. Gazet e naftës dhe hidrokarbure të tjera gazoike për përdorim të ndryshëm nga ai si lëndë djegëse për motor automjetesh.	6.38533 lekë/litri
E600 Hidrokarburet aciklike	2901	Hidrokarburet aciklike	39.37623 lekë/kg
E700 Hidrokarburet ciklike	2902	Hidrokarburet ciklike	39.37623 lekë/kg
E800 Metanol (Alkooli metilik)	29051100	Metanol (alkooli metilik)	Sipas përcaktimeve të neneve 50 e 51 të ligjit
L000	34 03 19 10 34 03 99 00	Preparate për lubrifikimin e makinerive, pajisjeve dhe automjeteve	42.5689 lekë/kg
L000 Preparatet antiplasëse, frenues oksidimi; Alkibenzenet e përziera	3811 dhe 3817	Preparatet antiplasëse, frenues oksidimi, stabilizator rrëshire, përmirësues viskoziteti, kundër korrozionit, dhe elemente shtesë të përgatitura për vajrat minerale (përfshirë benzinën) apo lëngje të tjera të përdorura për qëllime të tjera si vajrat minerale Alkibenzenet e përziera dhe Alkinaftalenet e përziera	Sipas përcaktimeve të neneve 50 e 51 të ligjit
E920 Biodiezel	3826 00	Acidet yndyrore /Biodiezel me më pak se 70% vajra nafte të kapitullit 27	39.37623 lekë/litri
V. FISHEKZJARRËT			
F000 Fishekzjarrët	36 04 10 00	Fishekzjarrët	212.84449 lekë/kg
F000	36 04 90 00	Të tjera	212.84449 lekë/kg
VI. GOMAT			

P100 Goma të reja	40 11	Goma të reja pneumatike prej gome	21.28445 lekë/kg
P200 Goma të riveshura	40 12 (përveç 40 12 20 00)	Goma pneumatike të riveshura; goma mishi apo të zakonshme; veshja e jashtme (pjesa me lule) dhe fashetat e gomës	42.5689 lekë/kg

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr._____, datë_____

PËR

PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT "PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.61/2012, "PËR AKCIZAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR"

Në mbështetje të neneve 81, pika 1, dhe 100, të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Propozimin e projektligjit "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.61/2012, "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar", për shqyrtim e miratim në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, sipas tekstit dhe relacionit që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

MINISTRI I FINANCAVE

PETRIT MALAJ